



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

05.06.2023

Drejtuar: **BOE "SHKELQIMI 07" & "FLED" & "S&L STUDIO"**
me adresë Fier Qender - MALLAKASTER BELISHOVE Fshati Belishov,

Procedura e prokurimit/lotit: **"E hapur punë publike - Prokurim me mjete elektronike"**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-64190-03-29-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: **"Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë – Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth"**

Fondi limit: **197,254,215.96** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: **15.5 Muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. **30** datë **3 Prill 2023**



Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto **X**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE "SHKELQIMI 07" & "FLED" & "S&L STUDIO"

K68121808W / K17621104C / L61606040D

Vlera në Lekë **166,320,000.00** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e njëzet mijë) pa TVSH.

2. OE "PE - VLA - KU"

K61716013M

Vlera në Lekë **177,588,250.00** (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) pa TVSH.

3. BOE "BE - IS SH.P.K" & " ERGI" & "T & XH"

K71412003A /

K02727229P / L72121504I

Vlera në Lekë **184,115,000.00** (njëqind e tetëdhjetë e katër milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE "PE - VLA - KU"

K61716013M

Skualifikohet operatori ekonomik "PE-VLA-KU"sh.p.k , pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në DST, konkretisht :

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 1 (b) Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3.

Sigurimi i ofertës i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i pavlefshëm pasi nuk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor por një Institucioni tjetër.

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), sipas kërkesave të DST



Nga Operatori Ekonomik nuk është paraqitur - 1 (një) inxhinier mekanik, pjesë e stafit mbështetës të kërkuar në pikën 2.3.6.

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve (Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Nga Operatori Ekonomik në deklaratën e paraqitur për drejtuesin teknik të punimeve inxhinieri i propozuar është i deklaruar në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor

2 BOE “BE - IS SH.P.K” & “ ERGI” & “T & XH” K02727229P / L72121504I

K71412003A /

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BE-IS & ERGI & T & XH” sh.p.k pasi nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht

- Nuk kanë plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërper mendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga operatori ekonomik konkretisht “T & XH” nuk është paraqitur asnjë punë e ngjashme me objektin që prokurohet si dhe me punimet që ka marrë përsipër të realizojë (punimet e veprave të artit dhe drenzimit, ndërtim ure).



- Nuk kanë plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), sipas kërkesave të DST

Nga Operatoret Ekonomik nuk është paraqitur - 1 (një) inxhinier mekanik, pjesë e stafit mbështetës të kërkuar në pikën 2.3.6.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE "SHKELQIMI 07" & "FLED" & "S&L STUDIO"** me adresë me adresë Fier Qender - MALLAKASTER BELISHOVE Fshati Belishov, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **166,320,000.00** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e njëzet mijë) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra **210** (dyqind e dyzet e gjashtë) është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Rrugor Shqiptar**, me adresë **"Rruga Sami Frashëri Nr.33 Tiranë"**, Tel **042234487** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Evis Berberi

